

## MENDIM PAKICE

1. Unë, anëtarja e trupit gjykues Etleda Çiftja, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini, pas konkluzionit që shumica ka arritur se subjekti: (i) arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (ii) arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; dhe (iii) ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

2. Në mbështetje të qëndrimit kundër, po argumentoj në vijim arsyet mbi të cilat kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, të cilat në përfundim më kanë çuar në vlerësimin se subjekti i rivlerësimit duhet të ishte shkarkuar nga detyra për shkak se: (i) nuk arriti nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë; dhe (ii) nga vlerësimi tërësor, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, për sa më poshtë vijon:

### **I. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

3. **Për apartamentin e banimit**, me sipërfaqe banimi 97.16 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përbashkët 10.74 m<sup>2</sup>, sipërfaqe tarrace 25.95 m<sup>2</sup>, si dhe një post garazhi, të ndodhura në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit:

*i. Nuk shpjegoi bindshëm dhe nuk provoi mospërputhjet që ekzistonin në lidhje me datën, numrin e pasurisë dhe çmimin e kontratës së shitjes, midis kontratës së depozituar nga noterja dhe kontratës së administruar nga ZVRPP-ja Tiranë, pasi:*

3.1 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ kryesisht, konstatoi dhe i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit se: (i) në kontratën e dorëzuar në ZVRPP ka korrigjim të datës së nënshkrimit (mban datën 17.11.2017), si dhe të numrit të pasurisë objekt i kësaj kontrate, në ndryshim nga kontrata e dërguar në Komision nga noterja G.B.; dhe (ii) ka mospërputhje lidhur me pagesën e kryer në favor të shoqërisë sipërmarrëse, pasi referuar kontratës së shitjes së pasurisë apartament (datë 17.11.2017) është paguar vlera totale prej 90.000 euro, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2 (dërguar nga Komision në datën 5.2.2019), subjekti ka deklaruar se ka si detyrim ndaj shitësit shumë prej 5.000 euro.

3.2 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se *ka vetëm një kontratë për shitblerjen e pasurisë, atë të datës 17.7.2017, me nr. \*\*\*, nënshkruar me palën shitëse para noteres G.B., si dhe është gabimi i noteres lidhur me deklarimin e pagesës së plotë prej 90.000 euro, në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së datës 17.7.2017, me nr. \*\*\*. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit depozitoi dy deklaratat noteriale<sup>1</sup>.*

3.3 Unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij të barrës së provës nuk shpjegoi bindshëm mospërputhjet që ekzistonin në lidhje me datën e nënshkrimit,

---

<sup>1</sup> Dy deklaratat noteriale të datës 19.11.2019 me nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* dhe dokumente të tjera bashkëlidhur tyre.

numrin e pasurisë, midis kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 17.7.2017<sup>2</sup>, të depozituar nga noteri publik dhe kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 17.11.2017<sup>3</sup>, të depozituar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Fakti që objekti i kontratës, si element thelbësor i kontratës<sup>4</sup>, në rastin konkret numri i pasurisë, ishte i ndryshëm në kontrata me data të ndryshme, të krijoj dyshime të arsyeshme se nuk bëhet fjalë për të njëjtën pronë.

3.4 Në vlerësim të sa më lart, unë, si anëtarë në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm dhe nuk provoi se këto gabime ishin me të vërtetë material, pasi subjekti për asnjë moment nuk dërgoi korigjimin e aktit i cili ka pasojë ligjore për të, por dërgoi vetëm deklaratatë të noterit publik, i cili deklaroi se këto janë gabime material të saj. Unë vlerësoj se deklaratimet e subjektit dhe të noterit kanë vetëm efekt deklarativ dhe jo provues dhe, si e tillë, nuk duhet të ishte konsideruar si shpjegim i bindshëm shpjegimi dhe vlera e provës nga shumica e trupit gjykues.

3.5 Në lidhje me mospërputhjet e deklaratimit të subjektit gjatë pyetësorit dhe kontratës së shitjes për pagesën prej 5.000 euro, jam dakord me vlerësimin e shumicës se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë se nuk e ka paguar shumën prej 5.000 euro, siç dhe parashikohet në kontratën e shitjes së apartamentit në vitin 2017.

3.6 Në konkluzion të sa më lart, unë, si anëtarë në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm dhe me të vërtetësi mospërputhjet që ju kaluan si barrë prove dhe, për rrjedhojë, nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ.

**ii. Ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratimin e datës së pagesës së këstit të parë prej 50.000 euro dhe mjaftueshmërisë së burimit të të ardhurave të ligjshme, referuar deklaratës “Vetting” dhe DPV-së së vitit 2015.**

3.7 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ kryesisht, konstatoi dhe i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provonte të kundërtën e konstatimit se: (i) ka mospërputhje lidhur me deklaratimet e bëra nga subjekti për datën e pagesës së këstit të parë për prenotimin e këtij apartamenti; (ii) evidentohet mospërputhje midis deklaratimit të subjektit në pyetësorin nr. 2 dhe dokumentacionit të administruar në dosje; (iii) burimi i të ardhurave të deklaruara nga subjekti për shlyerjen e shumës prej 50.000 euro në datën 7.4.2015 ka qenë i pamjaftueshëm për vlerën prej 10.400 euro, për shkak se:

3.8 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” të vitit 2017, subjekti ka deklaruar se në datën 14.4.2015 ka kryer pagesën prej 50.000 euro, këstin e parë për prenotimin e kësaj pasurie, ndërkohë që:

1. Subjekti deklaroi gjatë hetimit se e ka paguar këstin e parë në datën 7.4.2015 dhe e vërtetoi nëpërmjet mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 7.4.2015, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku vërtetohet

<sup>2</sup> Administruar nga Komisioni me nr. \*\*\*prot., datë 3.1.2019.

<sup>3</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2018.

<sup>4</sup> Sipas nenit 663 të Kodit Civil: “Konditat e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës” parashikohet se: ‘Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkak i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji.’”

se shuma e arkëtuar nga subjekti në datën 7.4.2015 është 50.000 euro, me përshkrimin “për blerje ap. nr. \*\*\* (107.9 m<sup>2</sup>), këst i parë pallati me leje ndërtimi nr. \*\*\* (protokoll)”<sup>5</sup>.

2. Në DPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar se shuma 50.000 euro e paguar në vitin 2015 ka si burim mbylljen e fondit të investimeve në “Raiffeisen Invest” në vlerën 37.400 euro dhe pakësimin e gjendjeve *cash* nga kursimet deri në vitin 2014, në vlerën 12.600 euro.
3. Referuar të dhënave nga “FI Bank”<sup>6</sup> rezulton se deri në datën 7.4.2015, kohë kur është kryer pagesa sipas mandatarëkëtimit nr. \*\*\*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka tërhequr gjithsej shumën 27.000 euro, konkretisht, në datën 3.4.2015 është tërhequr shuma 20.000 euro dhe në datën 7.4.2015 është tërhequr shuma 7.000 euro.

**3.9 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, shpjegon se shumën prej 50.000 euro e ka paguar në datën 7.4.2015 si rezultat i shumës prej 37.400 euro që i dispononte në bankë + shumën e parave *cash*. Pavarësisht se në datën 7.4.2015 ka shpenzuar më shumë nga paratë *cash* që dispononte në banesë për të mbuluar shumën prej 23.000 euro, gjendjes *cash* në shtëpi për pak ditë, i ka shtuar shumën prej 10.600 euro të tërhequra nga banka pas datës 7.4.2015. Pra, subjekti pretendon se ka deklaruar saktësisht që shuma prej 50.000 euro, paguar ndërtuesit në datën 7.4.2015, është shumatore e parave të familjes së subjektit që i dispononin në bankë dhe gjendjes *cash* në banesë.**

3.10 Unë, si anëtare në pakicë, çmoj se vlerësimi i kryer nga shumica nuk është në përputhje me faktet dhe rrethanat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, pasi subjekti i rivlerësimit jo vetëm që e pranoi se nuk kishte deklaruar saktë momentin e pagesës, por gjatë shpjegimeve të tij ka ndryshuar deklarinimin në lidhje me burimin e krijimit të shumës 50.000 euro, duke nxjerrë në pah një pasaktësi tjetër në deklarinimin e tij në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

3.11 *Në konkluzion të sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarinim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklarinimin e pasurisë dhe mjaftueshmërisë së burimit të të ardhurave të ligjshme për pagimin e këstit të parë prej 50.000 euro, referuar deklaratës “Vetting” dhe DPV-së së vitit 2015.*

**iii. Nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin origjinën e burimit të krijimit të pagesës së këstit të parë në deklaratën “Vetting”.**

3.12 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 se burim për pagesën e pjesës prej 37.400 euro të këstit të parë ka shërbyer kredia në shumën 5.000.000 lekë e marrë në “Raiffeisen Bank” në datën 15.2.2007, për trajtim për strehim si funksionar i lartë i shtetit.

3.13 Ndërkohë që gjatë hetimit rezultoi e provuar se si burim për shlyerjen e këstit të parë të këtij apartamenti ka shërbyer mbyllja e fondit të investimeve në “Raiffeisen Invest” dhe më tej transferimi dhe tërheqja nga “FI Bank”, siç edhe vetë subjekti deklaroi në përgjigje të pyetjeve gjatë hetimit.

---

<sup>5</sup> Në përgjigje të pyetësorit datë 9.2.2019 subjekti ka deklaruar se kësti i parë në vlerën prej 50.000 euro është shlyer në datën 7.4.2015.

<sup>6</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 3.5.2018.

3.14 Sipas pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës: “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”

3.15 Unë, si anëtare në pakicë, çmoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë burimin e krijimit të pagesës së kështit të parë në deklaratën “Vetting” në raport me DPV-në e vitit 2015 dhe provat e administruara gjatë hetimit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin burimin e këtij kështi në deklaratën “Vetting” dhe kjo përbën pamjaftueshmëri në lidhje me deklarinimin e burimit të krijimit.

***iv. Ka mungesë të burimeve të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues për krijimin e shumës 37.400 euro përfituar nga “Raiffeisen Invest”.***

3.16 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë se shuma prej 27.000 (37.400 euro), përfituar nga mbyllja e fondit të investimeve në “Raiffeisen Invest” e ka burimin nga shuma prej 5.000.000 lekësh përfituar nga kredia e marrë në datën 15.2.2007, pasi nga hetimi rezulton e vërtetuar se:

1. Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kredia për strehim e marrë në janar të vitit 2007, për shkak të mospërdorimit është depozituar në Bankën e Shqipërisë në titullin Bono Thesari (shuma e përfituar në total 156.000 lekë). Gjithashtu, subjekti deklaroi se gjysma e kredisë në vlerën 2.500.000 lekë është depozituar në Bono Thesari në nëntor të vitit 2007, me afat 6-mujor, shuma e përfituar në total 72.000 lekë. Në fund të deklarinimit për kredinë, subjekti deklaroi se dokumentacionin për sa sipër e ka paraqitur në mars të vitit 2015 gjatë “procesverbalit të shpjegimeve të subjektit të deklarimeve të pasurisë, datë 25.3.2016”.
2. Me kontratën e kredisë bankare dhe hipoteke me nr. \*\*\*, datë 15.2.2007, midis subjektit të rivlerësimit dhe “Raiffeisen Bank” palët kanë rënë dakord që banka do t’i japë kredimarrësit/subjektit një kredi në shumën 5.000.000 lekë, për blerje apartamenti. Kredia është disbursuar/kaluar në llogari të subjektit në datën 20.2.2007, në vlerën 2.970.000 lekë dhe personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në datën 27.2.2007 ka tërhequr cash shumën prej 2.946.000 lekësh.
3. Personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka kryer këto veprime me Bankën e Shqipërisë: (i) në datat 19.4.2007 – 19.7.2007 ka blerë Bono Thesari me afat 3-mujor, në vlerën 500.000 lekë; (ii) në datat 26.4.2007 – 25.10.2007 ka blerë Bono Thesari me afat 6-mujor, në vlerën 4.500.000 lekë; (iii) në datat 25.10.2007 – 24.4.2008 ka blerë Bono Thesari me afat 6-mujor, në vlerën 2.500.000 lekë; (iv) në datat 24.4.2008 – 16.10.2008 ka blerë Bono Thesari me afat 6-mujor në vlerën 2.500.000 lekë.
4. Gjendja e Bonove të Thesarit është 2.500.000 lekë në datën 31.12.2007 dhe 0 (zero) lekë në datën 31.12.2008.

5. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratimet e tij në ILDKPKI<sup>7</sup> në datën 25.3.2016, deklaroi se shumën prej 2.500.000 lekësh të tërhequr në datën 24.7.2007 e ka kaluar gjendje *cash* në banesë në vitin 2007, dhe në vitin 2008 ka pasur gjendje *cash* në banesë shumën prej 5.000.000 lekësh.
6. Në DPV-të e viteve 2007, 2008, 2009 dhe 2010 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendjen *cash* prej 2.500.000 lekësh për vitin 2007 dhe gjendjen *cash* prej 5.000.000 lekësh në vitin 2008 dhe po të njëjtën gjendje 5.000.000 lekë për vitet 2009 dhe 2010.
7. Bashkëshortja e subjektit ka depozituar në datën 28.7.2011 në “Raiffeisen Bank” shumën prej 33.000 euro, shumë të cilën në datën 8.2.2013 e ka kaluar në fondin e “Raiffeisen Invest”. Sipas deklaratimit të subjektit kjo shumë ka si burim kredinë e marrë në vitin 2007 në vlerën 5.000.000 lekë<sup>8</sup>.

3.17 Bazuar në sa paraqita më lart, unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, gjendjen *cash* në banesë dhe, si rrjedhojë, burimi i deklaruar i shumës së paguar për këstin e parë prej 27.000 euro (37.400 euro e pretenduar), nuk buron nga kredia e marrë në vitin 2007 dhe, për rrjedhojë, pagimi i këstit të parë nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme shoqëruar me dokumentacion justifikues.

3.18 *Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues për të vërtetuar se shuma 37.400 euro ka si burim kredinë e marrë në vitin 2007 në shumën 5.000.000 lekë, pasi nuk provoi këtë burim krijimi. Më tej, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar të ardhurat e përfituar nga kredia e vitit 2007 si gjendje *cash* në fund të vitit në DPV-të e viteve 2007, 2008, 2009 dhe 2010. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e tij të deklaratimeve të kursimeve në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar është jo vetëm në kundërshtim me ligjin, por edhe pretendim alogjik në kuptim të nocionit të kursimit.*

3.19 Vlerësimi i mësipërm mbështetet edhe në qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për interpretimin dhe zbatimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në veçanti lidhur me kuptimin e pasurisë së ligjshme, e ndërlidhur me momentin e deklaratimit në deklaratat periodike të likuiditeteve. Kolegji ka trajtuar në disa vendime edhe pretendimet e ngritura lidhur me deklaratimin e likuiditeteve, konkretisht në vendimet (JR) nr. 11/2019, (JR) nr. 19/2019, si më poshtë:

1. Në vendimin nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të tij, përcaktohet se: “[...] Në përfundim, trupi gjykues çmon se analiza ekonomiko-financiare në formë tabelare, e paraqitur nga subjekti, nuk ka vlerë provuese në drejtim të mënyrës së deklaratimit të kursimeve të subjektit dhe të personave të lidhur me të, si dhe të mënyrës së përdorimit prej tyre të këtyre kursimeve. Për rrjedhojë, këto kursime në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, shesat dhe pakësimet e tyre do të merren parasysh nga trupi gjykues, sipas deklaratimeve të subjektit

<sup>7</sup> Procesverbal i shpjegimeve të subjektit të deklaratimeve të pasurisë, datë 25.3.2016.

<sup>8</sup> Procesverbal i shpjegimeve të subjektit të deklaratimeve të pasurisë, datë 25.3.2016.

*dhe personave të lidhur me të, në deklaratat periodike/vjetore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi [...].”*

2. Në vendimin nr. 19/2019, në pikën 84 të tij, përcaktohet se: “[...] *Lidhur me deklarin gjatë gjyqimit mbi mbajtjen e shumës prej 900.000 lekësh si cash në shtëpi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në cash në vlerat 300.000 lekë dhe 600.000 lekë, respektivisht në deklaratat periodike vjetore të vitit 2003 dhe në atë të vitit 2004. Në vijim, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar ndryshime, shtime apo pakësime të gjendjes cash. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të theksojë se si subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së prej vitit 2003, mbështetur në ligjin nr. 9049/2003, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte çdo ndryshim të mundshëm të gjendjes së kursimeve cash, nëse kjo kishte ndodhur në vitin respektiv. Në formularin e deklaratës së pasurisë, në seksionin: ‘Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme’, kërkohet nga deklaruesit: Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në: [...] të çdo lloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Kjo rubrikë e deklaratës detajon detyrimin për zbatim të nenit 4, germa ‘d’ e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, që parashikon: [...] Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] brenda datës 31 mars të çdo viti gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...].”*

3.20 Në përfundim të analizës ligjore dhe ekonomike për këtë apartament, unë, si anëtare në pakicë, referuar provave dhe fakteve, si dhe jurisprudencës së mësipërme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, lidhur me pasurinë “shtëpi banimi, me sipërfaqe banimi 97.16 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përbashkët 10.74 m<sup>2</sup>, sipërfaqe tarrace 25.95 m<sup>2</sup>, si edhe një post garazhi, të ndodhura në rrugën “\*\*\*”, Tiranë (sipërfaqe totale 132.70 m<sup>2</sup>)”, vlerësoj se, në kuptim të pikave 1 dhe 5, të nenin D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, **subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi nuk ka deklaruar saktë këtë pasuri në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, si dhe nuk mbulon me burime të ligjshme shlyerjen e kështit të parë prej 37.400 euro për këtë apartament.**

4. Në lidhje me analizimin e gjendjes financiare për vitet 2003 – 2014, për burimin e krijimit të shumës 12.000 euro, subjekti i rivlerësimit:

*i. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesat e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve për vitet 2004, 2009, 2010, 2011 dhe 2014, për shkak se:*

4.1 Komisioni, në përfundim të hetimit administrative kryesisht, konstatoi dhe i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provonte të kundërtën e konstatimit se, referuar analizës së treguesve financiarë

për vitet 2003 – 2014, të kryer bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në vetëdeklarimet e subjekti, subjekti kishte një balancë negative të fondeve për vitet 2004, 2009, 2010, 2011 dhe 2014 në shumën prej 1.101.308 lekësh.

4.2 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë plotësisht të kundërtën e barrës së provës në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme, të shoqëruara me dokumentacion justifikues për shumën prej 1.101.308 lekësh, pasi:

1. Për vitin 2004, vlerësoj se nuk duhet marrë në konsideratë shuma prej 121.600 lekësh, marrë në formë dietash nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnje<sup>9</sup>, pasi dieta prezumohet si shpenzim dhe jo e ardhur.
2. Për vitin 2014, nuk duhet të merret në konsideratë dhurata nga vëllezërit, z. D.M., dhe z. E.M., pasi nuk ka dokumentacion ligjor provues për këto të ardhura.

4.3 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesat e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve për vitet 2003 – 2014.

4.4 *Unë, si anëtar në pakicë, çmoj se referuar balancës negative të fondeve për periudhën 2003 - 2014, se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar shumën prej 12.600 euro, pjesë e pagesës së këstit të parë në vitin 2015 nga gjendja cash në banesë.*

4.5 Në përfundim të analizës ligjore dhe ekonomike për pagesën e shumës 12.600 euro nga kursimet familjare, pjesë e këstit të parë prej 50.000 euro, unë, si anëtare në pakicë, referuar provave dhe fakteve lidhur me pasurinë “shtëpi banimi, me sipërfaqe banimi 97.16 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përbashkët 10.74 m<sup>2</sup>, sipërfaqe tarrace 25.95 m<sup>2</sup>, si dhe një post garazhi, të ndodhura në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë (sipërfaqe totale 132.70 m<sup>2</sup>)”, vlerësoj se, në kuptim të pikave 1 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, **subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, pasi nuk mbulon me burime të ligjshme shlyerjen e një pjese të këstit të parë prej 12.600 euro nga kursimet familjare për vitet 2003 – 2014.**

5. **Për dhuratat nga vëllezërit të deklaruara në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, për shkak se:**

5.1 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ kryesisht, konstatoi dhe i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provonte të kundërtën e konstatimit se vlerat e deklaruara në deklaratën “Vetting” si të ardhura të dhuruara nga vëllezërit e tij, të dërguara nëpërmjet institucioneve financiare, nuk përputhen me të ardhurat e dokumentuara të dërguara nëpërmjet këtyre institucioneve financiare (shkresat e AK Invest dhe Unionit Financiar).

5.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, shpjegon se nga shpejtësia e përpilimit të përgjigjeve për t'i paraqitur dokumentacionet në datën 27.1.2017 ka bërë

<sup>9</sup> Në bazë të vërtetimit nr. \*\*\*prot., datë 25.11.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje.

bashkim aritmetik të vlerave, por pas raportit dhe rishikimit me hollësi të të gjithë dokumentacioneve rezultoi se një nga të dhënat ishte e dubluar. Më tej, subjekti shpjegon se në deklaratën “Vetting” të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, gabimisht, duke pasur në konsideratë kursin e këmbimit të dollarit me lekun, ka përlllogaritur këmbimin e shumës 400 dollarë afërsisht me 450.000 lekë të vjetra dhe gabimisht e ka shënuar në deklaratë 450.000 lekë të reja.

5.3 Unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën “Vetting” me vërtetësi dhe saktësisht. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi dhe provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit.

5.4 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

**6. Për shumën prej 800.000 lekësh, të deklaruara gjendje *cash* në banesë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të një pjese të burimeve financiare të ligjshme, për shkak se:**

6.1 Unë, si anëtar në pakicë, kam konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk mbulon me burime të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues, shlyerjen e të gjithë këstit të parë prej 50.000 euro në datën 7.4.2015 (37.400 euro nga “Raiffeisen Invest” + 12.600 euro nga kursimet familjare për vitet 2003 – 2014), për apartamentin e blerë në vitin 2015 në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.

6.2 Bazuar në konkluzionin e mungesës së burimeve të ligjshme sipas pikës më lart, dhe përlllogaritjeve të vlerave monetare *cash* në fund të vitit 2016, sipas deklaramit në ILDKPKI, pa marrë në konsideratë këtu vlerën e tërhequr nga kredia e disbursuar në tetor të vitit 2016 (shuma prej 5.200.000 lekësh), e cila nuk është deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2016, unë, si anëtar në pakicë, dal në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 800.000 lekë, të deklaruara në deklaratën “Vetting “ të vitit 2017.

6.3 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vlerën e deklaruar *cash* prej 800.000 lekësh, pasi subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, të shoqëruara me dokumentacion justifikues për të krijuar gjendjen *cash* deri në datën 26.1.2017, kur ka dorëzuar deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

## **II. Në lidhje me cenimin e besimit të publikut tek drejtësia**

**7. Për kredinë me kushte lehtësuese, të përfituar në vitin 2007, në shumën 5.000.000 lekë, me interes 3 %, për shkak të funksionit si prokuror, subjekti i rivlerësimit:**

*i. Ka kryer një sërë veprimesh juridike fiktive të simuluar, për të siguruar marrjen e kredisë, sjellje të cilat nuk përputhen me sjelljet etike që një prokuror pritët të ketë dhe, më konkretisht:*



- 7.1 Nënshkrimi i një kontrate sipërmarrjeje apartamenti me nr. \*\*\*, datë 7.11.2006, të porositjes nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., apartamenti \*\*\*, në seksionin \*\*\*, në kuotën \*\*\*, me sipërfaqe totale 92 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përbashkët 10.6 m<sup>2</sup>, në Linzë, Tiranë, për shumën 55.000 euro, me qëllim që të aplikonte për kredi të butë në “Raiffeisen Bank” sipas kontratës së kredisë bankare dhe hipotekës lidhur në datën 15.2.2007.
- 7.2 Deklarimi i subjektit të rivlerësimit, i paprovuar me dokument shkresor se ka paguar këstin e parë *cash* në vlerën 15.000 euro, në datën 7.11.2006.
- 7.3 Deklarimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit se duke qenë se familjes nuk iu duk si banesë e përshtatshme, për shkak të vendndodhjes në periferi të Tiranës, kjo kontratë nuk është zbatuar, pra, nuk është ekzekutuar asnjëherë për shkaqe të padakordësisë me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. – të paprovuar me dokumentacion shkresor.
- 7.4 Deklarimi i subjektit se z. A.D., administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., i ktheu shumën prej 15.000 euro, pasi ishin dakordësuar në mirëbesim – të paprovuar me dokumentacion shkresor.
- 7.5 Konfirmimi i subjektit të rivlerësimit se kontrata e sipërmarrjes datë 7.11.2006, nuk është zbatuar dhe se për të është kryer vetëm pagesa e këstit të parë në momentin e nënshkrimit të saj, shumë e cila i është kthyer nga ndërtuesi brenda vitit 2007, sipas dakordësimit që kishin bërë palët në mirëbesim mes tyre – të paprovuar me dokumentacion justifikues.
- 7.6 Mungesa e burimeve të ligjshme, të shoqëruara me dokumentacion justifikues në shumën prej 2.500 euro nga huadhënësi Gj.Xh., që kishte shërbyer si burim për pagimin e shumës 15.000 euro si këst i parë për apartamentin.
- 7.7 Referuar veprimeve dhe deklarimeve më lart – unë, si anëtare në pakicë, çmoj se palët nuk kanë pasur si qëllim që të sillnin pasojat juridike të parashikuara në kontratë, në të kundërt do të kishin marrë masa për të vepruar sipas klauzolave të kontratës. Pra, subjekti i rivlerësimit ka kryer disa veprime juridike fiktive (ku palët nuk kanë për qëllim të sjellin pasojën juridike që shprehin se dëshirojnë), të cilat, për më tepër, janë fokusuar në ngritjen e një mekanizmi transaksionesh që të mundësojnë përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, ndonëse banesa, për të cilën kredia ishte akorduar, nuk ishte sipas kushteve që vetë subjekti dëshironte (ku sipas subjektit ishte në një zonë afër qendrës, për shkak të rrezikut që i kanosej).
- 7.8 Në këtë kuptim, transaksionet e kryera për shitblerjen e apartamentit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., thjesht për të realizuar marrjen e kredisë dhe pagesën e këstit *cash* prej 15.000 euro, si dhe kthimin e saj pa ndonjë dokumentacion shkresor, duket se janë kryer në mashtrim të ligjit. Nëpërmjet kryerjes së këtyre transaksioneve, subjekti ka synuar pikërisht të përfitojë një kredi me kushte lehtësuese, por që pas përfitimit të saj i ka përdorur për të investuar në Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar destinacionin e përdorimit të shumës së siguruar nga kredia e butë, për qëllime të përfitimit nga interesat e Bonove të Thesarit nga fondet**

***shtetërore me interes shumë të ulët, të konceptuara për të shërbyer në një destinacion tjetër, duke evidentuar paligjshmëri në këto veprime, për shkak se:***

- 7.9 Në deklaratën “Vetting”, në rubrikën “deklarimi i pasurisë” subjekti ka deklaruar kredinë për strehim me kushte lehtësuese, për shkak të pozicionit të tij si prokuror, të marrë në janar të vitit 2007. Subjekti deklaroi se për shkak të mospërdorimit është depozituar në Bankën e Shqipërisë në titullin Bono Thesari (shuma e përfituar 156.000 lekë). Gjithashtu, subjekti shpjegoi se gjysma e kredisë në vlerën 2.500.000 lekë është depozituar në Bono Thesari në nëntor të vitit 2007 me afat 6-mujor, shuma e përfituar 72.000 lekë.
- 7.10 Rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka përdorur shumën e përfituar nga kredia e butë në vitin 2007, në shumën 5.000.000 lekë sipas destinacionit të përshkruar në kontratë, duke pasur parasysh se kjo kredi e butë është e destinuar dhe e konceptuar si një ndihmë dhe suport që shteti e ofronte për funksionarët e tij në kushte të pamundësisë apo vështirësisë për të siguruar strehimin me burimet e tyre financiare.
- 7.11 Në DPV-në e vitit 2007, në rubrikën “të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kredia e marrë për strehim në vitin 2007 për shkak të prishjes së kontratës së porosisë/sipërmarrjes dhe mospërdorimit të menjëhershëm është depozituar nga bashkëshortja e tij në Bankën e Shqipërisë, nën titullin Bono Thesari, me afat 6 muaj. Gjithashtu, subjekti deklaroi se gjysma e kredisë, në vlerën prej 2.500.000 lekësh, është depozituar sërish nga bashkëshortja në nëntor të vitit 2007, nën titullin Bono Thesari me afat 6 muaj.
- 7.12 Subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga interesat e depozitave në Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë.
- 7.13 Sipas dokumentacionit të administruar nga Banka e Shqipërisë, vërtetohet se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka kryer veprimet bankare, si vijon: (i) në datën 11.4.2007, shuma prej 5.000.000 lekësh është transferuar në llogarinë bankare në lekë të bashkëshortes së subjektit, znj. H.M.; (ii) në datën 13.4.2007, shuma prej 5.003.500 lekësh është investuar për Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë; (iii) në datën 19.7.2007 është transferuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit shuma prej 498.792 lekësh, me përshkrimin “transferim fonde me kërkesë të klientit nga Bono Thesari”; (iv) në datën 25.10.2007 bashkëshortja e subjektit ka tërhequr nga llogaria e Bonove të Thesarit shumën prej 2.000.000 lekësh; (v) në datën 26.10.2007, shuma prej 500.000 lekësh është tërhequr *cash* nga bashkëshortja e subjektit; (vi) në datën 16.10.2008 është kthyer nga investimi për Bono Thesari shuma prej 2.489.304 lekësh; dhe (vii) në datën 5.12.2008 bashkëshortja e subjektit tërheq *cash* nga llogaria e saj në “Raiffeisen Bank” shumën prej 2.495.000 lekësh.
- 7.14 Më tej, në DPV-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar faktin se kredia e marrë për strehim në vitin 2007, për shkak të mospërdorimit të menjëhershëm është depozituar nga bashkëshortja e tij në Bankën e Shqipërisë, nën titullin Bono Thesari, me afat 6 muaj, duke deklaruar edhe të ardhurat e përfituara nga interesat.

7.15 Pakica vlerëson se përpjekja e subjektit të rivlerësimit për të përfituar një kredi me kushte lehtësuese, e destinuar dhe e konceptuar si një ndihmë dhe suport që shteti e ofronte për funksionarët e tij në kushte të pamundësisë apo vështirësisë për të siguruar strehimin me burimet e tyre financiare, mbetet e pajustificuar dhe e padrejtë në kuptimin etik.

7.16 Në vlerësimin tërësor në lidhje me këtë kredi, unë, si anëtare në pakicë, çmoj se e gjithë veprimtaria për realizimin e këtyre veprimeve juridike, si para dhe pas përfitimit të kredisë ka elemente të paligjshme brenda saj, të cilët afektojnë legjitimitetin e pasurisë së krijuar në përmbyllje të këtij transaksioni, pavarësisht faktit nëse kjo është një pasuri e shtuar ose jo e subjektit, por që sigurisht është një pasuri në pronësi të tij, për pasojë objekt verifikimi, për sa i përket ligshmërisë në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

7.17 Në këto kushte, kjo sjellje përbën shkelje etike të figurës së prokurorit dhe e ndërlidhur me shkelje të tjera të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, ndikon në vlerësimin e përgjithshëm në drejtim të cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**8. Për denoncimet nga publiku dhe ankesat e regjistruara në Prokurorinë e Përgjithshme, për të cilat Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, sipas vlerësimit tim si anëtar në pakicë:**

*i. Nuk shpjegoi bindshëm dhe nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit (për ato raste kur i ishte kërkuar) për disa nga denoncimet nga publiku dhe ankesat e depozituara në Prokurorinë e Përgjithshme, nga sa më poshtë vijon:*

**8.1 Ankesat e gazetarit A.Xh., të protokolluara me nr. \*\*\*, datë 6.1.2014 dhe nr. \*\*\*, datë 6.1.2014, drejtuar online (me e-mail) Prokurorit të Përgjithshëm,** për të cilën Komisioni i kaloi barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe për të dërguar prova për konstatimin se: (i) ka vonesa në kryerjen e veprimeve hetimore; (ii) janë të vakëta përpjekjet e subjektit për të thërritur dhe pyetur të dyshuarin kryesor, në fazën e hetimeve paraprake; (iii) ankuesi (pala e dëmtuar) ka referuar disa përpjekje për të marrë dijeni për ecurinë e hetimeve; (iv) nuk është njoftuar i dëmtuari (z. A.Xh.) për zgjatjen e afateve hetimore; (v) vendimi i gjykatës referon mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore nga ana e subjektit për këtë rast.

**8.2 Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 13.4.2018, i shtetasve D. D, A. D., dhe D. D.,** për të cilën Komisioni i kaloi barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe për të dërguar prova për konstatimin se: (i) për një kohë të gjatë nuk është regjistruar në regjistrin përkatës emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale; (ii) nuk janë trajtuar nga subjekti në mënyrën e duhur kërkesat/memoret e ankuesve, por nga zv/drejtuesi kërkesa e datës 29.3.2018; (iii) nuk disponohet informacion mbi përgjigjen e subjektit për Prokurorinë e Përgjithshme për kërkesat/memoret për informacion të bëra nga ankuesit; (iv) nuk disponohet informacion nëse subjekti i ka kthyer përgjigje kërkesës së bërë nga Avokati i Popullit për këtë rast.

**8.3 Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 5.6.2019, i shtetasit N.S.,** për të cilën Komisioni i kaloi barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe për të dërguar prova për konstatimin se: (i) nuk janë

respektuar afatet kohore për sa i përket vendimeve të ndërprerjes të përgjimit; (ii) në kërkesat e bëra nga subjekti për vazhdimin e përgjimeve nuk ka reflektuar të dhënat e reja të përfituara nga hetimi, por është mjaftuar me të njëjtën kërkesë/arsyetim që e ka bërë që në fillim të hetimeve, çka duket se e bën kërkesën e subjektit një akt të pamotivuar, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale; (iii) palët nuk janë informuar në kohë për shtyrjen e afateve hetimore; dhe (iv) pa i hyrë themelit të çështjes, duket se ka mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore nga ana e subjektit për të dyshuarin kryesor D.S., (N.).

**8.4 Denoncimi datë 11.12.2019, i shtetasit L. M.**, i cili denoncon subjektin e rivlerësimit për kryerjen e disa shkeljeve të rënda, ku në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka hequr dosjet hetimore disa prokurorëve duke ia kaluar prokurorëve të tjerë *“të preferuarve tuaj”*, pa dhënë dorëheqjen të parët dhe pa një vendim që të justifikonte kalimin e dosjeve. Në lidhje me këtë denoncim, Komisioni i kërkoj shpjegime dhe prova subjektit për konstatimin se: (i) në vendimet e zëvendësimit për këto raste nuk evidentohen procedurat e zhvillimit të shortit në rishpërndarjen e këtyre çështjeve; (ii) në disa vendime zëvendësimi i referohet zhvillimit të shortit manual dhe se po ashtu në një vendim zëvendësimi vërehet siglimi i subjektit në cilësinë e drejtuesit *“të hidhet me short”*, vendim në të cilin duket se paraprakisht emri i prokurorit zëvendësues ka qenë i pashënuar dhe është shënuar me shkrim dore. Në rastet e tjera nuk përmendet në vendim zhvillimi i shortit, mbi bazën e të cilit duhej bërë rishpërndarja e çështjeve; (iii) nga verifikimi i rasteve të zëvendësimit ku përmendet zhvillimi i shortit manual, konstatohet se në të 12 rastet e zëvendësimit, dosjet i janë caktuar të njëjtit prokuror; (iv) gjithashtu, konstatohet se 10 nga 13 dosje/raste të tjera (trajtuar më parë nga dy prokurorë të caktuar në Grupin e Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, që harton raportet e vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit) i janë caktuar të njëjtit prokuror; (v) në një rast zëvendësimi është bërë për shkak të kërkesës së të pandehurve, shtetasve D.N., dhe M.S., dhe kërkesës për dorëheqje nga vetë prokurori i çështjes, z. F.L., nga përfaqësimi i akuzës në gjyq që ka të bëjë me të njëjtën çështje.

**8.5 Unë**, si anëtar në pakicë, pas shpjegimeve dhe provave të dërguara nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij të barrës së provës, si për rezultatet e para dhe ato të dyta, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm moskryerjen e disa veprimeve procedurale, mosnjoftimin e palëve në proces, mangësinë në kryerjen e hetimeve, mosnjoftimin e palëve për shtyrjen e afateve, mosshortimin e një çështjeje në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, etj., referuar barrës së provës për denoncimet nga publiku, të sipërcituara, dhe ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme.

**8.6 Megjithëse** subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm dhe nuk provoi të kundërtën e barrës së provës për këto denoncime dhe ankesa, unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, këto raste ndikojnë në vlerësimin tërësor, në drejtim të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **III. Vlerësimi i përgjithshëm**

Unë, si anëtar në pakicë, në vlerësim të përgjithshëm të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini, duke qenë se:

#### **A. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë**

*Në lidhje me apartamentin e banimit, subjekti i rivlerësimit:*

- i. Nuk shpjegoi bindshëm dhe nuk provoi mospërputhjet që ekzistonin në lidhje me datën, numrin e pasurisë dhe çmimin e kontratës së shitjes, midis kontratës së depozituar nga noterja dhe kontratës së administruar nga ZVRPP-ja Tiranë;
- ii. Ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaramin e datës së pagesës së këstit të parë prej 50.000 euro dhe mjaftueshmërisë së burimit të të ardhurave të ligjshme, referuar deklaratës “Vetting” dhe DPV-së së vitit 2015.
- iii. Nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin origjinën e burimit të krijimit të pagesës së këstit të parë ne deklaratën “Vetting”.
- iv. Ka mungesë të burimeve të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues për krijimin e shumës 37.400 euro përfituar nga “Raiffeisen Invest”, si pjesë e pagesës për këstin e parë.
- v. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesat e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve për vitet 2004, 2009, 2010, 2011 dhe 2014, për rrejdhojë ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk mbulon me burime të ligjshme shlyerjen e një pjese të këstit të parë të apartamentit prej 12.600 euro nga kursimet familjare për vitet 2003 – 2014.

*Për shumën e shuruar nga vëllezërit të deklaruara në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 - subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën “Vetting” të vitit 2017*

*Për shumën prej 800.000 lekësh, të deklaruara gjendje cash në banesë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 - subjekti i rivlerësimit ka mungesë të një pjese të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tyre.*

#### **B. Në lidhje me cenimin e besimit të publikut tek drejtësia**

*Për kredinë me kushte lehtësuese, të përfituar në vitin 2007, në shumën 5.000.000 lekë, me interes 3 %, për shkak të funksionit si prokuror, subjekti i rivlerësimit:*

- i. Ka kryer një sërë veprimesh juridike fiktive të simuluar, për të siguruar marrjen e kredisë, sjellje të cilat nuk përputhen me sjelljet etike që një prokuror pritet të ketë.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar destinacionin e përdorimit të shumës së siguruar nga kredia e butë, për qëllime të përfitimit nga interesat e Bonove të Thesarit nga fondet shtetërore me interes shumë të ulët, të konceptuara për të shërbyer në një destinacion tjetër, duke evidentuar paligjshmëri në këto veprime.

#### **C. Për denoncimet nga publiku dhe ankesat e regjistruara në Prokurorinë e Përgjithshme.**

Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm dhe nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit (për ato raste kur i ishte kërkuar) për disa nga denoncimet nga publiku dhe ankesat e depozituara në Prokurorinë e Përgjithshme.

#### **IV. Konkluzioni Përfundimtar**

- i.* Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë në pronësi – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, të ndërthurura edhe me jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- ii.* Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit.
- iii.* Subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, bazuar në vlerësimin tërësor, në kuptim pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

**SI PËRFUNDIM**, sipas meje, si pakicë në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, nuk ka krijuar një nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për këtë arsye, unë, si anëtar në pakicë, bazuar në prova dhe bindjen e brendshme, vlerësoj se shumica nuk duhet të kishte disponuar konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, por shkarkimin e tij nga detyra, sipas pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Anëtar Kundër**

**ETLEDA ÇIFTJA**